



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Dal fotoja, ky është 34-vjeçari që dyshohet se i vuri eksplozivin në shtëpinë e Armand Dukës



karate dhe pikturë

Gjakmarja në Lezhë, flet i afërmi i 17-vjeçarit: Nuk shprehej kurrë, i mbyllur në vetëvete! Merrej me



drejtësia e munguar, vrasesi bëri vetëm 7 vite burg! S'negociuam 13 vite më parë, djalli ishte i vogël



rugë para! Ia kemi bërë të qartë



Eksplozivë në shtëpinë e Dukës në Durrës, arrestohet pronari i biznesit blegtoral, klient i kompanisë së kreut të FSHFI Dyshohet për konflikte, ka dyqanin 500 metra larg shtëpisë ku vuri lëndën plasëse

Kronikë

Qëlloi me armë zjarri në drejtim të një lokali në Shkodër, kapet pas një dite autori! Ja motivi

Një ditë më parë, Kristian Kroni, 31-vjeç qëlloi me armë zjarri në drejtim të një lokal, e ndërsa i janë vënë prangat një ditë më pas.



Foto ilustruese



Redaksia

22 Janar, 18:49 | Përditësimi i fundit: 22 Janar, 19:04



A A

SHKODËR- Një ditë më parë, Kristian Kroni, 31-vjeç qëlloi me armë zjarri në drejtim të një lokal, e ndërsa i janë vënë prangat një ditë më pas.

Ai u arrestua sot nga uniformat blu të Shkodrës, pasi qëlloi me armë, por që fatmirësisht nuk përfundoi me persona të lënduar.



LEXO EDHE:
Dy vëllezër kanosin me armë zjarri 60-vjeçarin në Shkodër, shpallen në kërkim nga policia! Ngjarja dyshohet për motive pronësie

Nga sa mësohet referuar burimeve zyrtare nga Policia, e gjithë ngjarja ka ndodhur për motive banale. 31-vjeçari ka konsumuar alkool në lokal, është larguar dhe më pas është kthyer përsëri dhe ka qëlluar me armë zjarri, duke vënë në rrezik jetën e klientëve të tjerë në lokal.

Ndaj tij rëndojnë akuzat për veprat penale "Vrasja me dashje" e mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit".

"Zbardhet ngjarja e ndodhur mbrëmjen e djeshme, në lagjen "Skënderbeg", ku shtetasi K. K. qëlloi me armë zjarri, për motive të dobëta, drejt një lokali.

Falë veprimeve të shpejta e profesionale të kryera nga Forca e Posaçme Operacionale e DVP Shkodër u bë i mundur identifikimi, kapja dhe arrestimi i autorit të dyshuar.

Vihet në pranga 31-vjeçari, autori i dyshuar i kësaj ngjarjeje. Në vijim të veprimeve të kryera nga strukturat hetimore të DVP Shkodër, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme Operacionale të DVP Shkodër dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, u bë e mundur zbardhja e ngjarjes, identifikimi, lokalizimi, kapja dhe arrestimi i shtetasit K. K., 31 vjeç, banues në lagjen "Mark Lula", Shkodër.

Nga veprimet e para hetimore dyshohet se ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta. Shtetasi K. K., pasi ka konsumuar alkool në lokal, është larguar dhe më pas është kthyer përsëri dhe ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të lokalit, duke vënë në rrezik jetën e klientëve të tjerë në lokal. Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vrasja me dashje" e mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje e armëve të zjarrit", njofton Policia.

B.K./Shqiptarja.com

TAG:

Shkoder

kristian kroni

Policia e Shkodrës

te shtena me arme

Ndalohe

Sondazhi i ditës:

A duhet që Basha e Berisha të garojnë me kandidatë të përbashkët në zgjedhjet e pjesshme vendore?

Po

Jo

Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë



Analiza vjetore e punës së Policisë në Shkodër, Gledis Nano: Punoni më shumë për goditjen e grupeve kriminale! Zero tolerancë ndaj atyre që shpërdorojnë detyrën! Porositë për vitin 2022

26 Janar, 18:19

Politikë



Helidon Bushati jep dorëheqjen si drejtues politik i PD në Shkodër: Duhet një figurë që bashkon demokratët! Basha emëron Alibeajn! Pas Tritan Shehut në Gjiroka

26 Janar, 13:51

Politikë



Zbardhen emrat e Grupit të Rithemelimit për bashkinë e Shkodrës, Bardh Spahia dhe Voltana Ademi mes kandidatëve që do të votohen nga baza të dielën

Ergys Kavaja

26 Janar, 09:42

Kronikë



Aksident në Shkodër, 15-vjeçari humb kontrollin e makinës dhe përplasjet me murin, mbetet i plagosur bashkë me shokun e tij

25 Janar, 20:05

Bota



Terror në Gjermani/ 18-vjeçari hap zjarr gjatë leksionit duke vrarë 1 student, plagosur 3 të tjerë e më pas veten

25 Janar, 01:33

Kronikë



Aksident në Vaun e Dejës, makina përplas këmbëso

24 Janar, 23:07

Analiza



Ylli Pata: Të fshehtat që nxori kreu i PD Shkodër, kush i ngriti strukturat paralele në PD?!



Ylli Pata

24 Janar, 18:19

Politikë



Zgjedhjet vendore të 6 marsit, Xhaçka e deleguara e Ramës në Shkodër: Do marrim edhe votat e demokratëve

24 Janar, 16:02

Kronikë



VIDEO/ Përfshihet nga flakët një makinë në Shkodër, shkak dyshohet një shkëndijë elektrike

24 Janar, 09:41

Sociale



Temperaturat ekstreme, dy të rinjtë në Theth sfidojnë motin me borë, lahen në Ujëvarën e Grunasit! Edhe në Sarandë qytetari zhytet në detin Jon

23 Janar, 14:19

Kronikë



U arrestua në 2019 për trafik droge në Itali, Gjykata e Shkodrës nje vendimin, 45-vjeçari do vuajë dënimin në burgun e Reçit

23 Janar, 10:03

Kronikë



Qëllohet me armë drejt një lokali në Shkodër, shpallet në kërkim autori (EMRAT)

21 Janar, 21:51

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju